**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA MALËSI E MADHE**
**KËSHILLI**

Nr.2378 prot                                                    Koplik më: 04 / 09 /2025

**V E N D I M**

**Nr 30 , Datë 03 /09 / 2025**

**MBI PLANIN SOCIAL BASHKIA MALËSI E MADHE**

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 03.09.2025,bazuar në ligjin Nr 139 datë 17.12.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore".Ligjit Nr.57 datë 18.07.2019 "Për asistencen Sociale në Republiken e Shqipërise" Ligji Nr.121/2021 për sherbimet e kujdesit shoqeror në Republiken e Shqipërise.

V E N D O S I

1. Të miratojë Planin Social Shtator 2025-Shtator 2027, bashkangjitur dekomentacionin perkatës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore",

KRYETAR
Ilir Halaj

SEKRETAR
Emirjan Hasmujaj
Miratuar me 03.09.2025
Vota Pro 17
Vota Kunder 3
Vota Abstenim 8
Zbardhur me datë 04.09.2025

*Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
SEKTORI I SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. 2378 Prot. Koplik, me 01.09.2025

**PROJEKT-VENDIM**

**Lënda**: Dërgim dokumentacioni **Nr.___ Date___/___/2025**

***Mbi Planin Social Bashkia Malesi e Madhe***

Bazuar ne ligjin Nr.139 date 17.12.2015 "Per organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore". Ligjit nr.57, date dt. 18.07.2019, "Per asistencen Sociale ne Republiken e Shqiperise, Ligji Nr.121/20216 Per Sherbimet e kujdesit Shoqeror ne Republiken e Shqiperise.

**PROPOZOJ:**

1. Te miratoje Planin Social Shtator 2025- Shtator 2027, bashkangjitur dokumentacioni perkates.

**KRYETAR**

**TONIN MARINAJ**

Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

United Nations ALBANIA

unicef for every child

# BASHKIA MALËSI E MADHE

# PLANI SOCIAL VENDOR

ESA CONSULTING *U përgatit nga ESA Consulting me mbështetjen e UNICEF, në kuadër të projektit "Enabling local governments deliver efficient and effective social services to support vulnerable groups and empower families and communities"*

## PËRMBAJTJA


HYRJE.....3
1. PRIORITETET NË ZHVILLIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR.....5
2. ANALIZA E AKTORËVE TË PËRFSHIRË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE.....6
2.1 Situata e mbrojtjes dhe përkujdesjes në Bashkinë Malësi e Madhe.....6
2.2 Situata e grupeve vulnerabël dhe nevojat e tyre për shërbime.....7
*Tabela 1: Nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror sipas individëve/grupeve në nevojë*.....8
2.3 Partneriteti me OJF-të.....10
3. TREGUESIT SOCIALË.....10
4. VIZIONI, PARIMET DHE OBJEKTIVAT E PLANIT SOCIAL.....11
4.1 Parimet.....11
4.2 Vizioni.....11
4.3 Objektivat.....11
5. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT.....16
5. 1. Zbatimi.....16
5. 2. Monitorimi dhe vlerësimi.....17
MATRICA E PLANIT SOCIAL VENDOR 2025-2027.....19
REFERENCAT.....54
1. Vështrim i përgjithshëm.....

*Tabela 3. Numri i fëmijëve sipas njësive administrative dhe grupmoshave*.....58
3. Të dhëna mbi individët/grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.....59
3.1 Personat me aftësi të kufizuar.....59
*Tabela 4: Personat me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative*.....59
3. 2 Familje përfituese të ndihmës ekonomike.....59
*Tabela 5: Familje në ndihmë ekonomike*.....59
3.3 Punëkërkues të papunë.....59
*Tabela 6: Punëkërkues të rregjistruar në Zyrat e Punës sipas gjinisë dhe statusit*.....60
*Tabela 7: Punëkërkues të rregjistruar në Zyrat e Punës sipas nivelit arsimor*.....60
3.4 Fëmijët.....60
*Tabela 8: Treguesit për fëmijët*.....61
3. 5. Viktima të dhunës në familje.....62
3.6. Të moshuarit.....62
3.7. Familje të pastreha.....62
SHTOJCA 2. TREGUESIT PËR SHËRBIMET.....63
1. Shërbime të përkujdesit shoqëror komunitar.....63
2. Shërbimi në kopshte dhe çerdhe.....63
*Tabela 9. Shërbimi në kopshte*.....63
3. Shkollat.....64
*Tabela 10. Shërbimi në shkollat 9 vjeçare*.....64
*Tabela 11. Shërbimi në shkollat e mesme*.....64
4. Shërbimi shëndetësor.....65
*Tabela 12. Shërbimi shëndetësor*.....65
5 . Buxheti për shërbimet shoqërore.....

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

United Nations ALBANIA

unicef for every child

**PËRMBAJTJA**


HYRJE ..... 3
1. PRIORITETET NË ZHVILLIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR ..... 5
2. ANALIZA E AKTORËVE TË PËRFSHIRË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE ..... 6
2.1 Situata e mbrojtjes dhe përkujdesjes në Bashkinë Malësi e Madhe ..... 6
2.2 Situata e grupeve vulnerabël dhe nevojat e tyre për shërbime ..... 7
*Tabela 1: Nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror sipas individëve/grupeve në nevojë* ..... 8
2.3 Partneriteti me OJF-të ..... 10
3. TREGUESIT SOCIALË ..... 10
4. VIZIONI, PARIMET DHE OBJEKTIVAT E PLANIT SOCIAL ..... 11
4.1 Parimet ..... 11
4.2 Vizioni ..... 11
4.3 Objektivat ..... 11
5. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT ..... 16
5. 1. Zbatimi ..... 16
5. 2. Monitorimi dhe vlerësimi ..... 17
MATRICA E PLANIT SOCIAL VENDOR_2025-2027 ..... 19
REFERENCAT ..... 54
1. Vështrim i përgjithshëm ..... **Error! Bookmark not defined.**
*Tabela 2. Numri i banorëve në Bashkinë Malësi e Madhe (regjistri i gjendjes civile 2023)* ..... **Error! Bookmark not defined.**
*Tabela 3. Numri i fëmijëve sipas njësive administrative dhe grupmoshave* ..... 58
3. Të dhëna mbi individët/grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror ..... 59
3.1 Personat me aftësi të kufizuar ..... 59
*Tabela 4: Personat me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative* ..... 59
3. 2 Familje përfituese të ndihmës ekonomike ..... 59
*Tabela 5: Familje në ndihmë ekonomike* ..... 59
3.3 Punëkërkues të papunë ..... 59
*Tabela 6: Punëkërkues të rregjistruar në Zyrat e Punës sipas gjinisë dhe statusit* ..... 60
*Tabela 7: Punëkërkues të rregjistruar në Zyrat e Punës sipas nivelit arsimor* ..... 60
3.4 Fëmijët ..... 60
*Tabela 8: Treguesit për fëmijët* ..... 61
3. 5. Viktima të dhunës në familje ..... 62
3.6. Të moshuarit ..... 62
3.7. Familje të pastreha ..... 62
SHTOJCA 2. TREGUESIT PËR SHËRBIMET ..... 63
1. Shërbime të përkujdesit shoqëror komunitar ..... 63
2. Shërbimi në kopshte dhe çerdhe ..... 63
*Tabela 9. Shërbimi në kopshte* ..... 63
3. Shkollat ..... 64
*Tabela 10. Shërbimi në shkollat 9 vjeçare* ..... 64
*Tabela 11. Shërbimi në shkollat e mesme* ..... 64
4. Shërbimi shëndetësor ..... 65
*Tabela 12. Shërbimi shëndetësor* ..... 65
5 . Buxheti për shërbimet shoqërore .....




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

United Nations ALBANIA

unicef for every child

# HYRJE

Reforma Administrative Territoriale solli transferimin në nivel lokal të funksioneve menaxhuese në ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për grupet në nevojë. Ligji nr.13/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" përcaktuan qartësisht detyrimin e Bashkisë për të identifikuar nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror, për ti planifikuar dhe ngritur këto shërbime. Megjithatë Bashkia nuk është i vetmi aktor në adresimin e nevojave të këtyre grupeve, adresimi efektiv i të cilave kërkon domosdoshmërisht angazhim aktiv të të gjithë aktorëve lokalë përgjegjës për problematikat sociale dhe pjesëmarrje aktive të grupeve të interesit në programimin dhe planifikimin e tyre në përputhje me nevojat specifike të të gjithë kategorive.

Plani Social Vendor i Bashkisë Malësi e Madhe u përgatit nga ESA Consulting me mbështetjen e UNICEF, si pjesë e projektit "Mundësimi i qeverisjes vendore për të ofruar shërbime sociale efektive dhe efiçente për të mbështetur grupet vulnerabël dhe fuqizuar familjet dhe komunitetin[1]". Ai është një instrument i Bashkisë dhe strukturave lokale, për të garantuar në mënyrë të plotë përmbushjen e nevojave të kategorive vulnerabël në territorin e Bashkisë duke u siguruar atyre mbrojtje, përkujdesje dhe shanse për gjithëpërfshirje në komunitet.

Përgatitjes së Planit Social i paraprinu Raporti i Vlerësimit të Nevojave të Bashkisë Malësi e Madhe, i cili në thelb identifikoi kategoritë në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e kësaj Bashkie, shërbimet që ata marrin aktualisht, si dhe nevojat për ngritjen e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror në këtë territor. Raporti identifikoi gjithashtu edhe nevojat e strukturave të Bashkisë Malësi e Madhe për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Për kryerjen e vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror u përdor një kombinim i teknikave të ndryshme, mbledhjes së të dhënave parësore dhe dytësore, specifikisht: *kërkimi* për të analizuar kontekstin ligjor kombëtar, si dhe strategjitë dhe planet e zhvillimit lokal; përcaktim dhe *mbledhje e treguesve* që identifikojnë kategoritë në nevojë dhe përcaktojnë madhësinë e tyre; analizë e treguesve; *intervista gjysëm të strukturuara me stafin* e strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror për të identifikuar nevojat për strukturim, organizim dhe trainim të tij; *intervista me familje dhe individë* që përfitojnë nga programet e mbrojtjes sociale, *Tryeza konsultimi me aktorët publik dhe jopublik lokal e rajonal* me role e përgjegjësi specifike në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Në përputhje me nevojat e identifikuara ky Plan fokusohet në:

---

[1] *Enabling local governments deliver efficient and effective social services to support vulnerable groups and empoëer families and communities*

1. Ngritjen dhe funksionimin e strukturave të shërbimeve sociale, me qëllim organizimin në përputhje me parashikimet e reja ligjore për rolet dhe funksionet që duhet të ketë struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.

2. Fuqizimin e koordinimit ndërinstitucional në menaxhimin e rasteve sociale, pasi identifikimi, referimi dhe menaxhimi i rasteve sociale kërkon veprim të koordinuar të një numri aktorësh publik dhe jopublik, përfshirë edhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

3. Ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në përputhje me nevojat e identifikuara për shërbime. Ngritja e tyre do të jetë graduale përgjatë periudhës katër vjeçare të zbatimit të këtij plani.

4. Informimin e komunitetit vendor mbi shërbimet e kujdesit shoqëror dhe rrugët se si ti aksesojnë këto shërbime, pasi ky nuk është vetëm detyrim që rrjedh nga ligji për të drejtën e informimit, por edhe domosdoshmëri për të nxitur identifikimin e rasteve të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje dhe për ti referuar tek strukturat përkatëse që kanë kapacitetet për të adresuar nevojat e tyre.

ESA Consulting dhe UNICEF falenderojnë për bashkëpunimin Bashkinë Malësi e Madhe. Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shkodër dhe të gjitha institucionet publike në territorin e kësaj Bashkie dhe të qarkut Shkodër për përfshirjen aktive në procesin e përgatitjes së Planit Social Vendor.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALËSI E MADHE

# 1. PRIORITETET NË ZHVILLIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Duke mbajtur në konsideratë kategoritë në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, madhësinë e secilit grup në nevojë dhe vendodhjet e tyre në territorin e Bashkisë, shërbimet egzistuese në këtë territor, largësinë gjeografike të njësive administrative nga qendra e Bashkisë Malësi e Madhe, si dhe kapacitetet e pritshme financiare të kësaj Bashkie të identifikuara në Raportin e Vlerësimit të Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shoqëror, Plani Social përcakton këto prioritete për periudhën 2025-2027:

***1. Rimodelim i roleve dhe funksioneve të strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror të Bashkisë dhe zhvillim i qasjes ndërsektoriale në menaxhimin e rasteve:***

- Strukturat e plotësuara me burime njerëzore numerikisht dhe profesionalisht, do të mbështeten përmes trainimeve specifike për të ushtruar efektivisht rolet dhe funksionet në përputhje me paketën legjislative në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- Zhvillimi i aftësisë së Bashkisë për të luajtur rolin drejtues dhe koordinues mes institucioneve publike dhe jopublike në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, me qëllim zhvillimin e qasjes ndërsektoriale në menaxhimin e rasteve sociale.
- Përfshirjen e kategorive vulnerabël në proceset e planifikimit dhe të menaxhimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

***2. Rivitalizim i shërbimeve egzistuese:***

- Riorganizim dhe plotësim me shërbime i Qendrës ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara;
- Ngritje dhe funksionim i Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit si njësi që kanë rolin kryesor për (i) informimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre dhe shërbimet e kujdesit shoqëror; (ii) identifikim proaktiv i rasteve të individëve në nevojë për shërbime dhe referimi tek shërbimet specifike; (iii) menaxhim të rasteve sociale.
- Trajtimi me prioritet i kategorive në nevojë përmes programeve të strehimit;

***3. Ngritje dhe funksionim i shërbimeve të reja:***

- Shërbime të emergjencës për viktimat e dhunës në familje;
- Shërbime të emergjencës veçanërisht për fëmijë pa kujdes prindëror, persona me aftësi të kufizuara dhe të moshuar në nevojë për përkujdesje të menjëhershme;
- Ngritja dhe funksionimi i Qendrës multifunksionale për fëmijën dhe familjen në njësinë administrative Malësi e Madhe;
- Shërbim në shtëpi për persona me aftësi të kufizuar dhe të moshuarit;
- Shërbimi i kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror në familje kujdestare;
- Zhvillimi i programit specifik për integrim në tregun e punës për personat mbi 55 vjeç;
- Shërbime për persona me aftësi të kufizuara për grup moshën 21-60 vjeç;
- Ngritje e një çerdheje në njësinë administrative Koplik;

- Krijimi i lehtësive financiare për familjet në nevojë me qëllim përfshirjen në kopshte dhe çerdhe të fëmijëve;

## 2. ANALIZA E AKTORËVE TË PËRFSHIRË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE

### *2.1 Situata e mbrojtjes dhe përkujdesjes në Bashkinë Malësi e Madhe*

Të dhënat e mbledhura dhe të analizuara mbi grupet në nevojë për mbrojtje dhe shërbime të kujdesit shoqëror, konsultimet e zhvilluara me individë në nevojë për shërbime, strukturat përgjegjëse të Bashkisë për shërbimet shoqërore, si dhe me një numër institucionesh që kanë role dhe përgjegjësi në ofrim shërbimesh japin këtë situatë të mbrojtjes dhe përkujdesit në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe:

***Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale***, struktura përgjegjëse në nivelin e Bashkisë, përbëhet nga përgjegjësi i sektorit dhe tre specialistë. ***Sektori ushtron kryesisht role dhe që më së shumti janë role të Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit për Njësinë Administrative Koplik***. Sektorit i mungon roli koordinues, monitorues, mbështetës për nivelin e njësive adminsitrative dhe mbi të gjitha rol planifikues për shërbimet e kujdesit shoqëror, monitorues për shërbimet etj. Përshkrimet e punës së stafit të sektorit nuk i përgjigjen realitetit të ri ligjor si në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, mbrojtjes sociale, ashtu edhe mbrojtjes së fëmijës dhe barazisë gjinore e masat kundër dhunës në familje.

***Në nivelin e Bashkisë duhet të egzistonte Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës.*** Rolet dhe funksionet e kësaj njësie duhej të ishin në përputhje me parashikimet në Ligjin "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve". Nuk ka punonjës të mbrojtjes së fëmijës, në mungesë të tij menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje kryehet nga punonjësi social, pjesë e sektorit të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale. ***Në strukturë mungon pozicioni i koordinatorit vendor për barazinë gjinore dhe dhunën në familje***, detyrim ky nga Ligji për masat kundër dhunës në familje. Menaxhimin e rasteve të dhunës në familje e bën punonjësi social, pjesë e sektorit. Duke vlerësuar që dy punonjës të këtij sektori ushtrojnë detyra të administratorit shoqëror për njësinë administrative Koplik, rezulton që ***numri i personelit është i vogël për të përballuar detyrat e menaxhimit, administrimit, planifikimit dhe drejtimit në tre fusha: ndihmë ekonomike, aftësi e kufizuar, shërbime të kujdesit shoqëror.***

***Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit nuk janë ngritur.*** Me përjashtim të njësisë administrative Kelmend që ka një punonjës social, në njësitë e tjera administrative mungojnë stafet me punonjës social dhe punonjës të mbrojtjes së fëmijës, mungesë që pengon ushtrimin e funksioneve dhe të përgjegjësive të Bashkisë në këtë nivel të organizimit vendor që është shumë më pranë qytetarëve dhe nevojave të tyre. Administratorët shoqëror që në fakt duhet të administrojnë programin e pagesave kesh, për shkak të mungesës së punonjësve social dhe/ose

punonjësve të mbrojtjes së fëmijës janë të detyruar të menaxhojnë dhe rastet sociale që kërkojnë shërbime, ndërkohë që nuk janë të trainuar në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Mungesa e stafeve të dedikuara në njësitë administrative që të punojnë me programe specifike për të identifikuar individët në nevojë për shërbime dhe menaxhimin e rasteve sociale përmes ofrimit të shërbimeve reflektohet në numrin e ulët të rasteve që kanë kërkuar mbështetje përmes shërbimeve pranë njësive administrative. Konsultimi i të dhënave të identifikuara për individët në nevojë me institucionet jashtë Bashkisë, tregoi se në realitet ka shumë më tepër individë në nevojë, por që nuk i drejtohen strukturave të Bashkisë për mbështetje. Nuk ka programe që nxisin informimin e komunitetit mbi të drejtat për mbrojtje e shërbime, si dhe rrugët që mund të përdorin për të aksesuar shërbimet, si ato pak shërbime komunitare ashtu edhe shërbime rajonale apo kombëtare të kujdesit shoqëror.

***Ambientet e punës së strukturave të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki dhe njësi administrative nuk janë të përshtatshme*** si për nevojat e punës së stafit, ashtu edhe për nevojat e fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, apo kategorive të tjera në nevojë.
***Evidentohet mungesë e buxhetit për shërbime të kujdesit shoqëror, madje edhe për menaxhimin e rasteve emergjente, gjë që krijon një pengesë të rëndësishme në ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve.***

***Ka mungesë të theksuar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë territor.*** Aktualisht egziston vetëm një qendër ditore për fëmijë me aftësi të kufizuar, ndërkohë që nevojat e një numri të konsiderueshëm individësh në nevojë të identifikuar mbeten të paadresuara në kushtet e mungesës së shërbimeve. Personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e varfëra mbështeten në sfidat e tyre vetëm përmes programit të pagesave kesh, ndërkohë që kategori të tjera si viktima të dhunës në familje, fëmijë në nevojë për mbrojtje etj nuk përfitojnë asnjë lloj shërbimi.

***Qasja ndërsektoriale në menaxhimin e rasteve është tejet e rëndësishme.*** Grupet teknike ndërsektoriale me përfshirjen e përfaqësuesve të institucioneve funksionojnë sa herë thirren nga struktura përgjegjëse në Bashki për të lehtësuar menaxhimin e rasteve. Megjithatë as Grupi Ndërsektorial ad hoc, në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve dhe as Komiteti Drejtues Lokal në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës nuk janë ngritur.

### *2.2 Situata e grupeve vulnerabël dhe nevojat e tyre për shërbime*

Të dhënat e mbledhura dhe të analizuara për individët dhe grupet në nevojë në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe[2], si dhe mbi shërbimet egzistuese të kujdesit shoqëror[3] prezantohen në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim:

[2] *Shih Shtojca 2 e këtij Plani*
[3] *Shih Shtojca 3 e këtij Plani*

*Tabela 1: Nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror sipas individëve/grupeve në nevojë*

| Nr. | Individë/grupe në nevojë | Madhësia e grupit |
|---|---|---|
| 1 | Persona me aftësi të kufizuara | 793 individë |
| 2 | Përfitues të ndihmës ekonomike | 741 familje (58 përmes fondit 6%) |
| 3 | Punëkërkues të papunë | 1,082 individë |
| 4 | Viktima të dhunës në familje | 9 individë |
| 5 | Të pastrehë | 60 familje |
| 6 | Të moshuar në nevojë për shërbime | 400 |
| 7 | Raste divorci | 2 raste të raportuara, por ka një tendencë rritje |
| 8 | Fëmijë të akomoduar në shërbim rezidencial | 3 fëmijë |
| 9 | Fëmijë me aftësi të kufizuar në shërbim rezidencial | 0 fëmijë |
| 10 | Fëmijë viktimë e dhunës | 0 fëmijë |
| 11 | Fëmijë në familje përfitues të ndihmës ekonomike | 2,632 fëmijë |
| 12 | Fëmijë në nevojë për mbrojtje | Nuk ka të dhëna |
| 13 | Fëmijë me aftësi të kufizuara | 101 fëmijë |
| 14 | Fëmijë të arrestuar/ndaluar/dënuar | Nuk ka të dhëna |
| 15 | Fëmijë pa kujdes prindëror (të vendosur në familje kujdestare) | 9 fëmijë |

Në përputhje me nevojat e individëve dhe grupeve në nevojë të identifikuara, si dhe me shportën bazë të shërbimeve të kujdesit shoqëror të përcaktuar në VKM nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" Bashkia Malësi e Madhe në konsultim me aktorë të ndryshëm lokal dhe vetë grupet në nevojë identifikuan:

***1. Nevojat prioritare për shërbime të cilat përfshijnë veçanërisht:***

- Ngritja e shërbimeve të emergjencës për viktimat e dhunës në familje përfshin së pari ngritjen e strehës së emergjencës 72 orëshe, mbështetjen juridike dhe psikologjike të viktimave të dhunës, sikurse dhe trajtimin me prioritet për strehim të viktimave të dhunës në familje dhe këshillim për familjet që kanë përjetuar dhunë në familje.
- Ngritja e shërbimit të kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror, adreson nevojat e fëmijëve pa kujdes prindëror në nevojë për mbrojtje në situatë emergjente dhe në vijim, si dhe parandalon shërbimin rezidencial për fëmijë.

- Ngritja dhe funksionimi i qendrës multifunksionale do të krijoj mundësinë e ofrimit të shërbimeve për familjen duke kombinuar:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

- *Program për fëmijët e familjeve në ndihmë ekonomike. Shërbimet përfshijnë ushqim, mbështetje për edukim, mbështetje psikologjike dhe sociale, aktivitete të kohës së lirë që nxisin edukimin dhe integrimin*
- *Trajtim përmes pakove ushqimore dhe kiteve higjenike për rastet emergjente të familjeve apo individëve në nevojë.*
- *Shërbim reabilitues për fëmijët në konflikt me ligjin.*
- *Programe këshillimi për prindërimin.*
- *Programe për menaxhimin e zemërimit për prindërit e dhunshëm.*
- *Këshillim psikologjik individual për çdo fëmijë në nevojë për mbrojtje*
- *Programi i trajnimit të familjes kujdestare (shërbim i kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror të përkohshëm).*

➢ Për fëmijët me aftësi të kufizuara u konsiderua prioritare plotësimi i shërbimit në qendrën ditore me shërbimeve zhvilluese dhe reabilituese. Qendra do të mundësojë edhe transportin e fëmijëve nga zona më të largëta që kanë nevojë për shërbimin ditor. Shërbimi lëvizës u vlerësua i rëndësishëm në funksion të nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara që për shkak të distancës nga shërbimi e kanë të pamundur të përfitojnë nga shërbimi komunitar duke siguruar kështu shërbim në shtëpi për ta.

➢ Shërbime për persona me aftësi të kufizuara për grup moshën 21-60 vjeç, përmes ngritjes së një qendre multifunksionale që kombinon terapitë e zhvillimit, përfshirjen në terapi okupacionale në shërbime ditore, si dhe strehim të mbrojtur për rastet e braktisjes apo mungesës së kujdesit për personat me aftësi të kufizuara. Shërbimet në familje për personat e kësaj grupmoshe do të jenë gjithashtu pjesë e shërbimit të kësaj qendre.

➢ Qendër ditore dhe shërbim në familje për të moshuarit, është një shërbim i ri që parashikon të ngrihet për të adresuar nevojat në rritje për përkujdesje për të moshuarit më në nevojë.

➢ Nevoja për të mbështetur përtej pagesave kesh individët madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike do të adresohet përmes shërbimeve:
  - *Zhvillimit të një programi specifik për integrim në tregun e punës për pjestarët madhor të familjeve në ndihmë ekonomike, e veçanërisht identifikimit të zgjidhjeve për personat mbi 55 vjeç, në sajë të ndërveprimit me Shërbimin kombëtar të Punësimit dhe drejtorive të ndryshme të Bashkisë Malësi e Madhe.*
  - *Rritje e numrit të çerdheve dhe vendosja e kuotave në kopshte dhe çerdhe për fëmijët e familjeve më në nevojë për të marrë shërbimin pa pagesë.*
  - *Trajtimit me strehim social ose bonus qeraje të familjeve të pastreha.*

## *2. Menaxhimi i rasteve dhe referimi tek shërbimet*

Ngritja dhe funksionimi i Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, të fokusuara në identifikimin e individëve në nevojë për shërbime, menaxhimin e rasteve sociale, mbështetjen për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e shërbimeve komunitare do të mundësojë menaxhimin e rasteve sociale dhe referimin e tyre tek shërbimet respektive. Ndërkohë rritja e bashkërpunimit me aktorë të tjerë lokalë që kanë detyrime ligjore në mënyrë të

veçantë për mbrojtjen e fëmijëve dhe masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, do të ndikojë si në rritjen e identifikimit të rasteve të individëve në nevojë për shërbime ashtu edhe në menaxhimin më efektiv të rasteve sociale përmes qasjes ndërsektoriale dhe mbështetjes përmes shërbimeve të integruara.

### *2.3 Partneriteti me OJF-të*

Në periudhën kur u përgatit Plani Social, Bashkia Malësi e Madhe ishte në fazën e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me dy organizata "Gruaja tek Gruaja" dhe "Gruaja në Zhvillim". Edhe pse organizatat nuk kanë aktualisht projekte që lidhen me ngritje shërbimesh të përkujdesit shoqëror, ndërveprimi me to për zbatimin e komponentëve të këtij Plani në lidhje me adresimin e dhunës në familje dhe fuqizimin ekonomik të grave janë një vlerë e shtuar për Planin Social Vendor të Bashkisë Malësi e Madhe.

## 3. TREGUESIT SOCIALË

Mbledhja e treguesve social ishte një proces i rëndësishëm për përgatitjen e këtij plani, por që pavarësisht nga përpjekjet ka të dhëna që mungojnë, duke krijuar kufizime të vetë këtij Plani për të identifikuar qartësisht madhësinë e kategorive në nevojë, prej nga rrjedh edhe nevoja për të ngritur shërbimet e duhura për ta. Këto mungesa vijnë kryesisht nga mungesa e një praktike pune të mbledhjes së treguesve social si nga strukturat e Bashkisë, ashtu edhe nga aktorët e tjerë.

- Për të dhënat demografike u përdorën të dhënat më të fundit të gjendjes civile. Kjo e fundit nuk i raporton të dhënat sipas grup moshës dhe gjinisë, madje nuk raporton të dhëna as për numrin e fëmijëve të ndarë sipas grupmoshës dhe njësive administrative. Të dhënat për fëmijët u mundësuan nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
- Në sajë të rregjistrit elektronik kombëtar të ndihmës ekonomike Bashkia Malësi e Madhe zotëron të dhëna për familjet përfituese të ndihmës ekonomike dhe karakteristikat e këtyre familjeve. Gjithashtu Bashkia ka të dhëna të plota për personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët, sipas kategorive të verbër, para dhe tetraplegjikë dhe PAK mendor e fizik për çdo njësi administrative. Të dhënat janë të detajuara edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara, sipas grupmoshave dhe njësive.
- Bashkia nuk administron të dhëna për punëkërkuesit e papunë, por ndërvepron me Zyrën e Punës (në varësi të Shërbimit Kombëtar të Punësimit) për qëllime që lidhen me përfshirjen e individëve madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike në tregun e punës. Vijojnë të mbeten problem grupmoshat mbi 55 vjeç për të cilat raportohet mungesë në ofertat për punë.
- Të gjithë aktorët e konsultuar pranojnë se të dhënat për fëmijët në nevojë për shërbime në territorin e Bashkisë nuk janë të plota. Mungesa e të dhënave lidhet kryesisht me mungesën e njësisë së mbrojtjes së fëmijës në këtë Bashki, pra dhe të stafit të dedikuar për punën me fëmijët si për informimin për të drejtat e fëmijëve, ashtu edhe të identifikuar në mënyrë sistematike rastet në nevojë për mbrojtje.
- Të dhënat mbi numrin e të moshuarve në nevojë për shërbime nuk egzistojnë, edhe pse të gjithë aktorët e konsultuar pranojnë që egziston nevoja për shërbime për të moshuarit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALËSI E MADHE

- Numri i rasteve të dhunës në familje është më i lartë se sa shifrat e raportuara, pasi janë raportuar rastet me urdhër mbrojtje apo urdhër të menjëhershëm mbrojtje, ndërkohë që në shumë raste viktimat nuk i drejtohen institucioneve për mbështetje.
- Në territor nuk i identifikuan komunitete rome dhe egjiptiane.

Ky Plan Social do të adresojë nevojën për të mbledhur sistematikisht tregues social që do të ndihmojë si në identifikimin e nevojave në vijim e në zhvillim të kategorive vulnerabël në këtë territor, ashtu edhe në rishikimin e përvitshëm të Planit Social të Bashkisë Malësi e Madhe.

## 4. VIZIONI, PARIMET DHE OBJEKTIVAT E PLANIT SOCIAL

### *4.1 Parimet*

Plani Social Vendor i Bashkisë Malësi e Madhe mbështetet në parimet më të rëndësishme të sanksionuara në legjislacionin kombëtar:

1. Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara, etj.
2. Grupe të veçanta,përfshirë fëmijët, duhen të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë, bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.
3. Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm që të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve.
4. Individët janë përgjegjës për jetën e tyre dhe çdo shërbim duhet të respektojë parimin e pavarësisë dhe autonomisë sëtyre.
5. Koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë të tjerë në komunitet.
6. Vendimarrja në nivel vendor udhëhiqet nga standartet kombëtare.

### *4.2 Vizioni*

Bashkia Malësi e Madhe synon të ndërtoj një sistem vendor të mbrojtjes e përkujdesjes sociale të fokusuar tek nevojat e individit dhe familjes për ti mbrojtur, fuqizuar dhe riintegruar në jetën ekonomike sociale përmes ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror që janë pjesë e një sistemi të integruar dhe funksional shërbimesh në territorin e Bashkisë dhe ndërveprues me sistemet rajonale e kombëtare.

### *4.3 Objektivat*

Planit Social Vendor i Bashkisë Malësi e Madhe është i ngritur mbi katër objektiva strategjike të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe që përmbushja e secilës kontribuon në përmbushjen e vizionit të këtij institucioni për shërbimet e kujdesit shoqëror.

*Specifikisht:*




**Objektivi strategjik 1: Ngritja dhe funksionimi i strukturave të shërbimeve sociale**

Ky objektiv u formulua në përputhje me nevojën e identifikuar për ti organizuar strukturat në përputhje me parashikimet e reja ligjore për rolet dhe funksionet që duhet të ketë struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.

Objektivi do të përmbushet përmes:

1. Ristrukturimit dhe plotësimit të strukturës përgjegjëse në Bashki në përputhje me legjislacionin, ku përveç rishikimit të detyrave funksionale parashikohet ngritja e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës, plotësim i strukturës me koordinatorin për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje dhe koordinatorin për aftësinë e kufizuar. Struktura përgjegjëse në Bashki do të përmbushë edhe detyra të Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit për njësinë Koplik, por stafi do të ketë ndarje të qartë të detyrave për të mos miksuar detyrat e planifikimit, drejtimit strategjik për shërbimet e kudjesit shoqëror me detyrat e NJVNR.
2. Ngritjes në pesë njësitë administrative Qendër, Kastrat, Shkrel, Gruemirë dhe Kelmend të Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit e për rrjedhojë plotësimit të tyre me

punonjës social, si dhe plotësimi i strukturës me punonjës së mbrojtjes së fëmijës në njësinë administrative Gruemirë.

3. Ngritjes së kapaciteteve të strukturave të shërbimeve të kujdesit shoqëror, përmes ofrimit të një cikli trainimesh të ndërtuara në përputhje me detyrat funksionale dhe nevojat e identifikuara për ngritje kapacitetesh.
4. Ngritjes së infrastrukturës fizike dhe teknike të punës së strukturave të shërbimeve të kujdesit shoqëror në të dy nivelet: Bashki dhe njësi administrative.
5. Zhvillimit të treguesve social që mundësojnë monitorimin e vazhdueshëm të situatës së kategorive vulnerabël.
6. Rishikimi periodik i Planit Social Vendor, duke përfshirë në rishikim jo vetëm institucionet publike dhe ofruesit e shërbimeve, por edhe vetë përfituesit e shërbimeve.

## Objektivi strategjik 2: Fuqizimi i koordinimit ndërinstitucional në menaxhimin e rasteve sociale

Identifikimi, referimi dhe menaxhimi i rasteve sociale kërkon veprim të koordinuar të një numri aktorësh publik dhe jopublik, përfshirë edhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Bashkia ka rolin drejtues dhe koordinues mes të gjithë këtyre aktorëve. Përmbushja e këtij objektivi mundësohet përmes:

1. Takimeve informuese të NJVNR me institucione lokale për të nxitur identifikimin dhe referimin e rasteve sociale tek kjo strukturë.
2. Trainim i ndërlidhësve të komunitetit dhe kryetarëve të fshatrave për identifikimin e rasteve të individëve në nevojë për shërbime, pasi ata janë të kontakt të vazhdueshëm me komunitetet dhe janë një mundësi e mirë për të identifikuar e referuar individë në nevojë.
3. Ngritjen dhe funksionimin e Grupit Ndërsektorial ad hoc, në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe Grupit Teknik Ndërsektorial.
4. Takime informuese me institucionet vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve mbi punën e NJMF dhe detyrimet ligjore e institucionale reciproke në mbrojtjen e fëmijëve.
5. Ngritja dhe funksionimi i Komitetit Drejtues Lokal në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës, si dhe Ekipit Teknik Ndërdisiplinor për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.
6. Takime informuese me institucionet vendore përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave mbi detyrimet ligjore e institucionale reciproke në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.
7. Menaxhim i rasteve të individëve në nevojë për shërbime sipas qasjes ndërsektoriale.

## Objektivi strategjik 3: Ngritja dhe funksionimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

Një numër shërbimesh të reja janë parashikuar të ngrihen gradualisht në periudhën katër vjecare të zbatimit të këtij

plani, sikurse dhe plotësim i shërbimit ezgsitues të identifikuar në këtë Bashki. *Konkretisht:*

**Shërbime të emergjencës përfshijnë:**

1. ***Numër i dedikuar për rastet e emergjencës për individët në nevojë.*** *Në nivelin e Bashkisë vendoset dhe publikohet numër telefoni profesional i dedikuar për informim, koordinim, referim të rasteve të fëmijëve, viktimave të dhunës në familje dhe çdo rast emergjence në nevojë për mbrojtje dhe shërbim.*

2. ***Ngritja dhe funksionimi i shërbimit të emergjencës 72 orë për viktimat e dhunës në familje.*** *Kjo përfshin ngritjen e infrastrukturës fizike të këtij shërbimi, përshkrimet e punës dhe trainimi i stafit; 2 Shërbim ligjor dhe psikologjik përgjatë kohës së marrjes së shërbimit 72 orësh dhe shërbim riintegrues në vijim. Paketa ushqimore dhe higjenike.*

**Shërbimet komunitare për fëmijën dhe familjen përfshijnë:**

1. ***Ngritja dhe funksionimi i Qendrës multifunksionale për fëmijën dhe familjen në njësinë administrative Malësi e Madhe.*** Qendra përfshin shërbimet:

   - *Program për fëmijët e familjeve në ndihmë ekonomike. Shërbimet përfshijnë ushqim, mbështetje për edukim, mbështetje psikologjike dhe sociale, aktivitete të kohës së lirë që nxisin edukimin dhe integrimin*
   - *Trajtim përmes pakove ushqimore dhe kiteve higjenike për rastet emergjente të familjeve apo individëve në nevojë.*
   - *Shërbim reabilitues për fëmijët në konflikt me ligjin.*
   - *Programe këshillimi për prindërimin.*
   - *Programe për menaxhimin e zemërimit për prindërit e dhunshëm.*
   - *Këshillim psikologjik individual për çdo fëmijë në nevojë për mbrojtje*
   - *Programi i trajnimit të familjes kujdestare (shërbim i kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror të përkohshëm).*

2. ***Qendër ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe shërbim në shtëpi për aftësinë e kufizuar.*** *Qendra aktuale zgjeron shërbimin me terapi zhvillimi, reabilitim fizik, si dhe me shërbimin në shtëpi për persona me aftësi të kufizuara.*

3. ***Shërbime për persona me aftësi të kufizuara për grup moshën 21-60 vjeç.*** *Qendër multifunksionale që kombinon terapitë e zhvillimit, përfshirjen në terapi okupacionale në shërbime ditore, si dhe strehim të mbrojtur për rastet e braktisjes apo mungesës së kujdesit për personat me aftësi të kufizuara. Shërbimet në familje për personat e kësaj grupmoshe do të jenë gjithashtu pjesë e shërbimit të kësaj qendre.*

4. ***Qendër ditore dhe shërbim në shtëpi për të moshuarit.*** *Qendra ofron shërbime të kohës së lire dhe aktivitete për të moshuarit, shërbime shëndetësore dhe shërbim në familje në përputhje me standartet kombëtare për këto shërbime.*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

**Shërbimet në familje përfshijnë:**

1. ***Ngritja dhe funksionimi i shërbimit të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror në familje kujdestare.*** *Përfshin (i) Trainim i strukturave lokale përgjegjëse mbi shërbimin e kujdesit për fëmijë në familje kujdestare; (ii) Informimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit lokal për të qenë familje kujdestare; (iii) Identifikimi, orientimi dhe trainimi i familjeve kujdestare; (iv) Ndjekja e procedurave ligjore për regjistrimin e familjes kujdestare dhe ngritjen e regjistrit të familjeve kujdestare në Bashki.*
2. ***Qendra ditore*** *për fëmijë me aftësi të kufizuara zgjeron shërbimin me shërbimin në shtëpi për fëmijë me aftësi të kufizuara.*
3. ***Qendra për personat me aftësi të kufizuara 21-60 vjeç, si dhe qendra ditore për të moshuarit*** *ofrojnë dhe shërbime në familje në përputhje me standartet kombëtare.*

**Sistemi i pagesave kesh i ndërthurur me shërbimet e kujdesit shoqëror:**
Për familjet përfituese të ndihmës ekonomike do të punohet përmes qasjes së mbështetjes me ndihmë ekonomike, por si një masë tranzitore e shoqëruar me shërbime që fuqizojnë individët madhorë të familjeve në nevojë dhe i riintegrojnë në tregun e punës në sajë të bashkëpunimit me Shërbimin Kombëtar të Punësimit. Aktivitetet kryesore të parashikuara përfshijnë:

1. *Identifikimi i familjeve ekstremisht të varfra, përfituese dhe jopërfituese të ndihmës ekonomike.*
2. *Mbështetje emergjente për nevojat bazë të familjeve në nevojë përmes qendrës multifunksionale.*
3. *Referimi tek këshillimi për punësim.*
4. *Ndërveprimi me Shërbimin Kombëtar të Punësimit për zhvillimin e programeve të nxitjes së punësimit, duke mundësuar ngritjen e grupit të përbashkët të përbëra prej: Zyrës së punës, sektorit të ndihmës ekonomike të Bashkisë dhe administratorëve shoqëror, drejtorive të ndryshme të Bashkisë që zhvillojnë programe në sektorë të ndryshëm. Grupi harton një program specifik që jep zgjidhje për nxitjen e punësimit të moshës mbi 55 vjeç për të cilët nuk gjenden aktualisht alternativa punësimi, por dhe nuk përfitojnë nga programet e mbrojtjes përmes pagesave kesh;*
5. *Alokimi i kuotës prej 10% në çerdhe dhe kopshte për fëmijët në nevojë për mbrojtje.*
6. *Reduktim me 20% të pagesës për kopësht/çerdhe për fëmijë të familjeve në nevojë;*
7. *Trajtimi me bonus qeraje ose banesë sociale të familjeve të pastreha dhe në situatë të vështirë ekonomike.*
8. *Ngritje e një çerdhe të re në njësinë administrative Koplik.*

**<u>Objektivi strategjik 4:</u>**
**Informimi i komunitetit mbi shërbimet e kujdesit shoqëror dhe rrugët se si të aksesojnë shërbimet**

Informimi i komuniteve vendore mbi shërbimet e kujdesit shoqëror është domosdoshmëri për të nxitur identifikimin e rasteve të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje dhe për ti referuar tek

strukturat përkatëse që kanë kapacitetet për të adresuar nevojat e tyre, sikurse dhe detyrim që rrjedh nga ligji për të drejtën e informimit.

Analiza e Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shoqëror në Bashki tregoi se në realitet numri i individëve në nevojë është më i lartë, por rastet nuk i drejtohen gjithnjë strukturave përkatëse për të kërkuar mbështetje përmes shërbimeve. Kjo jo thjesht për shkak të mungesës së shërbimeve, por edhe të informimit se ku dhe si mund të kërkohet mbështetje. Për përmbushjen e këtij objektivi Plani parashikon disa masa specifike:

**1. Afishimi në ambientet publike të Bashkisë, njësive administrative dhe çdo institucioni publik pjesë e grupeve ndërsektoriale, i detyrimeve të institucioneve për:**

- *raportimin e dhunës në çdo institucion përgjegjës, publik ose jopublik*
- *të drejtat e fëmijës që lidhen me sektorin specifik.*
- *publikohet numri i kontaktit për referimin e rasteve (ku dhe si rë raportojnë rastet në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje)*

**2. Faqja e web e Bashkisë krijon një seksion të dedikuar për shërbimet sociale që përmban të paktën:**

- *legjislacionin për shërbimet e kujdesit shoqëror*
- *informim mbi të drejtat e fëmijëve, grave dhe grupeve vulnerabël për mbrojtje dhe përkujdesje*
- *informim për ku dhe si përfitohen shërbimet e përkujdesit social*
- *publikohet numri i kontaktit për referimin e rasteve*

**3. Takime komunitare:** *Në çdo njësi administrative, çdo vit Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në koordinim me kryetarin e fshtatit/ndërlidhësin e komunitetit përgatit Planin e Takimeve Komunitare me qëllim informimin e komunitetit për:*

- *të drejtat e fëmijëve dhe shërbimet specifike për ta*
- *masat kundër dhunës në familje*
- *ku e si të referohen rastet për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe rrugët se si përfitohen këto shërbime.*

## 5. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT

### *5. 1. Zbatimi*

Plani është parashikuar të zbatohet për një periudhë katër vjeçare dhe për çdo aktivitetet është përcaktuar koha e zbatimit, për përcaktimin e së cilës janë mbajtur në konsideratë dy faktorë:

1. Prioriteti i ndërhyrjes, në përputhje me vlerësimin e kryer të nevojave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË ... KËSHILLI ... E MA...HE

2. Kostoja e çdo aktiviteti dhe shpejtësia e ngritjes së fondit social lokal.

Duke qenë që janë ende në proces aktet nënligjore që rregullojnë mekanizmin e financimit, ndërhyrjet me kostot më të larta, kryesisht ngritja e shërbimeve komunitare, janë parashikuar të ndodhin në vitin e dytë, të tretë dhe të katërt të planit, duke përdorur vitin e parë jo vetëm për ngritjen dhe përgatitjen e strukturave lokale, si dhe të kushteve për ngritjen e rrjetit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, por edhe për të ngritur fondin social lokal të Bashkisë Malësi e Madhe me fonde kryesisht nga Bashkia, qeveria qendrore dhe donatorë.
Në plan është përcaktuar për çdo aktivitet njësia/stafi zbatues i aktivitetit specifik. Edhe pse zbatimi i planit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Bashkisë, partneriteti me institucione (siç është Shërbimi Social Shtetëror dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit) që kanë përgjegjësi ligjore në zbatimin e një aktiviteti specifik është pasqyruar në këtë Plan. Gjithsesi zgjerimi i këtij partneritetit me organizata/ofrues të tjerë do të mbetet detyrë e vazhdueshme e strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Malësi e Madhe.
Plani do të jetë objekt rishikimi çdo vit veçanërisht në funksion të atyre aktiviteve për të cilat duhet të mbahen në konsideratë zhvillimet afatshkurtra lokale dhe nevojat koherente të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.

### *5. 2. Monitorimi dhe vlerësimi*

Për efekt të monitorimit dhe vlerësimit për çdo aktivitet të Planit është parashikuar njësia/të përgjegjëse për për monitorimin e çdo aktivitetit, ndërkohë që për çdo aktivitet është përcaktuar lista e treguesve që lehtësojnë procesin e monitorimit dhe vlerësimit sasior dhe cilësor të çdo aktiviteti.

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit do të jetë verifikimi sesa efektiv ka qenë zbatimi i aktiviteteve, a janë përmbushur në mënyrë të sukseshme objektivat strategjikë dhe specifik të planit dhe mbi të gjitha çfarë ndikimi ka pasur zbatimi tek individët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit duhet të kalojë përmes:

a) Mbledhja e të dhënave;
b) Analizimi i të dhënave;
c) Raportimi;

Mbledhja e të dhënave dhe e informacionit të nevojshëm për matjen e treguesve të përcaktuar është një etapë thelbësore e procesit të monitorimit. Këto të dhëna do të përdoren për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara janë zbatuar në praktikë sipas specifikimeve përkatëse të Matricës së Planit (në sasinë dhe cilësinë e parashikuar), sikurse të dhënat e mbledhura do të japin pamje të qartë mbi arritjet dhe problematikat që kanë dalë gjatë zbatimit të Planit.

Të dhënat e mbledhura dhe të analizuara do të jenë bazë e Raportit njëvjeçar. Raporti do të shërbejë gjithashtu edhe për të rishikuar ato elementë të Planit trevjeçar që marrin një fokus të ri për shkak të arritjeve dhe problematikave të identifikuara në periudhën një vjeçare.

Gjatë periudhës së zbatimit do të kryhen tre vlerësime, të cilat do të influencojnë drejtpërdrejt ne riorganizimin dhe riformulimin e objektivave specifikë dhe aktiviteteve për vitet pasuese:

- 3 vlerësime dhe Raporte vjetore (fund i 2025, fund i 2026 dhe 2027). Këto raporte do shërbejnë edhe për të rishikuar Planin e Veprimit për vitin pasardhës.
- Vlerësimi dhe Raporti përfundimtar (fund i 2027). Ky raport do të shërbejë edhe për të përgatitur Planin pasardhës afatmesëm të Bashkisë.

Në përfundim të fazës përgatitore të këtij Plani stafi i strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror do të trainohet edhe për komponentin e monitorimit dhe vlerësimit me qëllim që të ketë kapacitetin për ta zhvilluar këtë proces të rëndësishëm. Ndërkohë vetë përfituesit e aktiviteteve të zbatuar në kuadër të këtij plani do të kenë zë në vlerësimin e tyre, pasi parashikohet konsultim i buxhetit dhe Planit Social Vendor të Bashkisë me fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufiuara dhe grupe në nevojë.

**Monitorimi dhe vlerësimi i jashtëm**
Bazuar në detyrimet ligjore, shumë prej aktiviteteve të përfshira në Plan Veprimi janë subjekt i monitorimit, kontrollit apo inspektimit nga institucione kombëtare si: Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektoriati Shëndetësor dhe i Mbrojtjes Sociale. Rezultatet e kontrolleve, monitorimeve apo inspektimeve do të mbahen gjithashtu në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit të Planit nga struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror të Bashkisë Malësi e Madhe.

# MATRICA E PLANIT SOCIAL VENDOR

## 2025-2027

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1 – NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

| AKTIVITETET | AKTORËT PËRGJEGJËS | AFATI | TREGUESIT | BURIMI I TË DHËNAVE | BURIMI I FINANCIMIT | KOSTO (lekë) | MONITORIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *<u>Objektivi specifik 1:</u> Riorganizimi strukturor dhe funksional në përputhje me detyrimet ligjore* | | | | | | | |
| **Aktiviteti 1.1: Rishikimi i strukturës dhe përshkrimeve të punës të Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale**[4]<br>*Rishikim i përshkrimit të punës për çdo pozicion dhe struktura*[5]*:*<br>o *Shef sektori*<br>o *Punonjës social -1 Koordinatori vendor për barazinë gjinore dhe dhunën në familje* | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale<br><br>Sektori i burimeve njerezore | 2025-2027 | Struktura përgjegjëse e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore;<br>Rregullorja e Bashkisë përmban përshkrim të ri pune për strukturën përgjegjëse dhe | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"<br>Ligji "Për vetëqeverisjen vendore<br>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br>Ligji "Për | Bashkia Malësi e Madhe | 7 536 000 | Nenkryetari i Bashkise |

[4] Bazuar në rekomandimin 1 të Raportit të Vlerësimit të Nevojave.
[5] Stafi social i kësaj strukture dhe administratorët shoqëror do të kryejnë dhe detyra të menaxhimit të rastit dhe funksioneve të pagesave kesh, por që këto detyra do të përcaktohen qartësisht dhe të ndara nga funksionet menaxhuese dhe planifikuese të pjesës tjetër të stafit të sektorit.

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| – *1 (shtesë)*<br>○ *Njësia e mbrojtjes së fëmijës – 2 (shtesë)*<br>○ *Administrator shoqëror – 2*<br>○ *Koordinator për aftësinë e kufizuar- 1 shtesë* | | | çdo specialisti sipas parashikimeve ligjore; | masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare"<br>Ligji "për ndihmën ekonomike" | | | |
| **Aktiviteti 1.2: Ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, plotësimet strukturore dhe rishikim i përshkrimeve të punës**[6]**.**<br>**Aktiviteti 1.2.1** *Ngritja e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësinë administrative* ***Qendër***<br>*Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:*<br>○ ***punonjës social - 1 (shtesë)***<br>○ *administrator shoqëror- 1*<br><br>**Aktiviteti 1.2.2:** *Ngritja e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësinë administrative* | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale | 2025-2027 | Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore;<br>Rregullorja e Bashkisë Malësi e Madhe përmban përshkrim të ri pune për strukturën e Nj.V.N.R në njësinë administrative dhe çdo specialisti sipas parashikimeve | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"<br>Ligji "Për vetqeverisjen vendore<br>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br>Ligji "për ndihmën ekonomike"<br>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" | Bashkia Malësi e Madhe | 9 420 000 | Nënkryetari i Bashkisë |

[6] *Në përputhje me Rekomandimin 2, Raporti i Vlerësimit të Nevojave*

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Kastrat***<br>*Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:*<br>o ***punonjës social - 1 (shtesë)***<br>o *administrator shoqëror- 1*<br><br>**Aktiviteti 1.2.3** *Ngritja e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësinë administrative* ***Shkrel***<br>*Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:*<br>o ***punonjës social - 1 (shtesë)***<br>o *administrator shoqëror- 1*<br><br>**Aktiviteti 1.2.4** *Ngritja e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësinë administrative* ***Gruemirë***<br>*Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:*<br>o ***punonjës social - 1 (shtesë)***<br>o ***punonjës i mbrojtjes së fëmijës – 1 (shtesë)***<br>o *administrator* | | | ligjore; | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *shoqëror- 1*<br><br>**Aktiviteti 1.2.5** *Ngritja e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësinë administrative* ***Kelmend***<br>*Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:*<br>o *punonjës social - 1*<br>o *administrator shoqëror- 1* | | | | | | | |
| ***Objektivi specifik 2:*** ***Ngritja e kapaciteteve të strukturave të shërbimeve të kujdesit shoqëror në përputhje me funksionet që përmbushin*** | | | | | | | |
| **Aktiviteti 2.1. Trainime për stafin e strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki.**<br>*Trainimet do të zhvillohen në përputhje me nevojat e identifikuara dhe reflektuara në Raportin e Vlerësimit të Nevojave[7] dhe konkretisht:*<br>o *Planifikimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror;*<br>o *Monitorimi dhe vlerësimi;*<br>o *Konsultimet me aktorët* | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale | 2025<br>2026<br>2027<br>2027 | Numri i trainimeve të zhvilluara në përputhje me fushatat e identifikuara për ngritje kapacitetesh;<br>Numri i pjesëmarrësve në trainim në përputhje me rolin dhe funksionin që | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"<br>Ligji "Për vetqeverisjen vendore<br>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br>Ligji "Për | Bashkia Malësi e Madhe<br>Partneritet me institucione në nivel kombëtar (SHSSH) dhe organizata joqeveritare | 1 180 000 | Nenkryetari i Bashkise |

[7] *Shih rekomandimin 3 në Raportin e Vlerësimit të Nevojave*

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *kryesorë:*<br>o *Puna me shërbimin jopublik, krijim rrjeti komunikimi dhe bashkëpunimi për ofrim shërbimesh dhe referime rastesh urgjente.*<br>o *Prokurimi i shërbimeve të kujdesit social;*<br>o *Hartimi i projekteve*<br>o *Buxhetimi i shërbimeve sociale*<br>o *Barazia gjinore dhe masa kundër dhunës në familje*<br>o *Mbrojtja e fëmijës* | | | kanë;<br>Praktika pune të përmirësuara në vijim të trainimeve si rezultat i kapaciteteve të rritura dhe shprehive të fituara nga trainimet; | masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare"<br>Ligji "për ndihmën ekonomike"<br>Ligji "Për të drejtën e informimit publik"<br>Ligji "Për prokurimin Publik" | | | |
| **Aktiviteti 2.2. Trainim i stafeve të Nj.V.N.R.**<br>*Trainimet do të zhvillohen në përputhje me nevojat e identifikuara*[8]*:*<br>o *Njohuri mbi paketën legjislative të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mbrojtjes së grupeve vulnerabël.*<br>o *Teknika të menaxhimit të rasteve sociale.*<br>o *Trainime specifike të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve për* | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale | 2025<br>2026<br>2027<br>2027 | Numri i trainimeve të zhvilluara në përputhje me fushatat e identifikuara për ngritje kapacitetesh;<br>Numri i pjesëmarrësve në trainim në përputhje me rolin dhe funksionin që kanë; | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"<br>Ligji "Për vetqeverisjen vendore<br>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br>Ligji "Për masa ndaj | Bashkia Malësi e Madhe në partneritet me institucione publike në nivel kombëtar (SHSSH) dhe organizata joqeveritare me ekspertizë në fusha specifike; | | Nenkryetari i Bashkise |

[8] *Shih rekomandimin 3 të Raportit të Vlerësimit të Nevojave*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *detyrimet që rrjedhin nga Ligji "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijës" dhe shërbimin e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror.*<br>o *Trainim i punonjësve social në mënyrë të veçantë për çështjet e dhunës në familje.* | | | Praktika pune të përmirësuara në vijim të trainimeve si rezultat i kapaciteteve të rritura dhe shprehive të fituara nga trainimet; | dhunës në marrëdhënien familjare"<br>Ligji "për ndihmën ekonomike"<br>Ligji "Për të drejtën e informimit publik" | | | |
| ***Objektivi specifik 3: Ngritja e infrastrukturës fizike dhe teknike të punës së strukturave të shërbimeve të kujdesit shoqëror në të dy nivelet*** | | | | | | | |
| **Aktiviteti 3.1: Përgatitja e paketës me formularët e dokumentimit që lidhen me menaxhimin e rasteve sociale dhe procedurat e referimit tek shërbimet e kujdesit shoqëror.**<br>*Paketa përgatitet nga Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale në përputhje me kërkesat ligjore dhe u dërgohet me udhëzimet përkatëse Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit*<br>*Gjithashtu përgatitet e dërgohet edhe adresari me* | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale | 2025 | Numri i formularëve të përgatitur sipas parashikimeve ligjore për çdo grup në nevojë për shërbime;<br>Paketa e dërguar zyrtarisht pranë NjVNR. | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM specifike që rrjedhin prej tij.<br>Ligji "Për vetqeverisjen vendore"<br>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve",<br>Vendimi i | Bashkia Malësi e Madhe | 48 000 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *të gjitha kontaktet e sistemit te referimit dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror.* | | | | Këshillit të Ministrave për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje<br>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" dhe VKM specifike në zbatim të tij.<br>Ligji "Për ndihmën ekonomike" | | | |
| **Aktiviteti 3.2. Përmirësimi i infrastrukturës fizike të punës në përputhje me nevojat për menaxhimin e rasteve sociale.**<br><br>*Këtu përfshihen ndërhyrjet infrastrukturore si në ambientet e punës së Sektorit të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore, ashtu edhe të Njësive të Vlerësimit të* | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale | 2025 | Ambientet e punës janë të përshtatshme për përmbushjen e detyrave funksionale dhe detyrimeve ligjore;<br>Mjedisi miqësor për fëmijët;<br>Mjedisi i sigurt për viktimat e dhunës në | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM specifike që rrjedhin prej tij.<br>Ligji "për vetqeverisjen vendore" | Bashkia Malësi e Madhe | 1 752 000 | Nenkryetari i Bashkise |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALËSI E MADHE

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Nevojave dhe referimit.*<br>*Specifikisht:*<br>o *Ambientet e punës së pajisura sipas nevojave të punës së stafit.*<br>o *Ambient i përshtatur për nevojat e punës me fëmijët (mjedis miqësor për fëmijët).*<br>o *Ambiente të aksesueshme për personat me aftësi te kufizuara*<br>o *Ambient miqësor për çdo individ në nevojë;* | | | familje;<br>Mjedisi miqësor dhe i aksesueshem për çdo individ në nevojë;<br>Stafi administron dokumentacionin në përputhje me parashikimet ligjore; | Ligji "për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" dhe VKM specifike në zbatim të tij. | | | |
| ***Objektivi specifik 4: Monitorimi i situatës së kategorive vulnerabël dhe rishikimi periodik i Planit Social Vendor*** | | | | | | | |
| **Aktiviteti 4.1. Përcaktimi i treguesve që identifikojnë kategoritë në nevojë dhe mbledhja periodike e të dhënave**[9] | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale | 2025<br>2026<br>2027<br>2027 | Lista e treguesve që do të mblidhen;<br>Frekuenca e mbledhjes së çdo | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e | Bashkia Malësi e Madhe | - | Nenkryetari i Bashkise |

[9] *Ky aktivitetet adreson mungesën aktuale praktikës së mbledhjes së të dhënave që shërbejnë në procesin e identifikimit të grupeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror*

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Struktura përgjegjëse:*<br>*1. identifikon treguesit që duhet të mblidhen*<br>*2. institucionet dhe ofruesit e shërbimeve nga duhet të merren të dhënat*<br>*3. frekuencën e mbledhjes së të dhënave*<br>*4. I drejtohet zyrtarisht me kërkesë për bashkëpunim për qëllime të mbledhjes së të dhënave të gjitha institucioneve të identifikuara dhe ofruesve të shërbimeve* | | | treguesi;<br>Institucionet dhe ofruesit e shërbimeve nga do të sigurohet mbledhja e të dhënave;<br>Treguesit e mbledhur në mënyrë periodike; | Shqipërisë" dhe VKM specifike që rrjedhin prej tij.<br>Ligji "për vetqeverisjen vendore"<br>Ligji "për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" dhe VKM specifike në zbatim të tij. | | | |
| **Aktiviteti 4.2. Monitorimi dhe rishikimi i Planit Social Vendor**<br>*Struktura përgjegjëse kryen analizë periodike multisektoriale të grupeve në nevojë për shërbime në territorin e Bashkisë, mbi bazë e të dhënave të mbledhura nga zbatimi i aktivitetit 4.1 (objektivi* | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale | 2025<br>2026<br>2027<br>2027 | Analiza e Vlerësimit të Nevojave të kryer;<br>Plani Social Lokal i rishikuar çdo vit; | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM specifike që rrjedhin prej tij.<br>Ligji "për | Bashkia Malësi e Madhe | - | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALËSI E MADHE

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *strategjik 1).*<br>*Mbi bazën e treguesve që matin zbatimin e çdo aktiviteti të parashikuar në Planin Social kryen vlerësimin e zbatimit të aktiviteteve të Planit një herë në vit*<br>*Mbi bazën e treguesve satistikor të analizuar, rezultateve të montiorimit të aktiviteteve dhe konsultimeve me grupet vulnerabël, drejton punën për rishikimin e Planit Social Vendor.* | | | | vetqeverisjen vendore"<br>Ligji "për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" dhe VKM specifike në zbatim të tij. | | | |
| **Aktiviteti 4.3. Konsultim i buxhetit dhe Planit Social Vendor të Bashkisë me fëmijët, gratë, persona me aftësi të kufizuara dhe grupe në nevojë.** | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale | 2025<br>2026<br>2027<br>2027 | Numri i konsultimeve të zhvilluara me fëmijët;<br>Numri i konsultimeve të zhvilluara me gratë;<br>Numri i konsultimeve të zhvilluara me persona me aftësi të fkuziara dhe grupe në | Ligji "për shërbimet e kujdesit shoqëror"<br>Ligji "për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës"<br>Ligji "për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare " | Bashkia Malësi e Madhe | 402 000 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | nevojë;<br>Ndryshimet e ndodhura në planet dhe buxhetin lokal sipas propozimeve të marra nga konsultimet e zhvilluara; | Ligj "për të drejtën për informim" | | | |

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2- FUQIZIMI I KOORDINIMIT NDËRINSTITUCIONAL NË MENAXHIMIN E RASTEVE SOCIALE

| AKTIVITETET | AKTORËT PËRGJEGJËS | AFATI | TREGUESIT | BURIMI I TË DHËNAVE | BURIMI I FINANCIMIT | KOSTO (ne lekë | MONITORIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Objektivi specifik 1:*** ***Zhvillimi i qasjes ndërsektoriale në menaxhimin e rasteve sociale*** | | | | | | | |
| **Aktiviteti 1.1. Takime informuese të stafit të Nj.V.N.R me institucione lokale për të nxitur identifikimin dhe referimin e rasteve sociale tek kjo strukturë**<br>*Takimet do të zhvillohen me Drejtues dhe mësues të shkollave në territorin e Bashkisë; Sistemin shëndetësor;* | Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (të gjitha) | 2025 | Numri i takimeve informuese të zhvilluara;<br>Numri i pjesëmarrësve në takimet e zhvilluara;<br>Përmbajtja e materialeve dhe | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"<br>Ligji "Për vetqeverisje n vendore"<br>Ligji "për | Bashkia Malësi e Madhe | 436 100 | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Gjyqtarë e prokurorë; Polici; Ofrues të shërbimeve lokale; media*<br><br>*Takimet do të synojnë t'i informojnë mbi shërbimet e NjVNR dhe shërbimet sociale në tërësi me qëllim referimin e rasteve të mundshme të individëve në nevojë për mbështetje.* | | | mesazheve të komunikimit përmbushin qëllimet e takimeve; Numri i rasteve që referohen nga institucione të ndryshme në vijim të takimeve në sajë të rritjes së të kuptuarit të funksionimit të mekanizmit të referimit tek shërbimet sociale; | mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës"<br>Ligji "për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare " | | | |
| **Aktiviteti 1.2. Trainim i ndërlidhësve të komunitetit dhe kryetarëve të fshatrave për identifikimin e rasteve të individëve në nevojë për shërbime**<br>*Duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me komunitetin, ata kanë më shumë shanse të identifikojnë individë në nevojë për shërbime dhe ti* | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale | 2027 | Numri i ndërlidhësve të komunitetit dhe kryetarëve te fshatrave pjesemarrës në trainim; Numri i personave të trainuar të | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji "Për vetqeverisjen vendore" | Bashkia Malësi e Madhe në bashkëpunim me SHSSH dhe/ose organizata partnere | 53 600 | Nenkryetari i Bashkise |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *referojnë tek NJVNR.*<br>*Trainimi do të synojë tu japë atyre një pamje të qartë të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mekanizmave egzistues lokal për të adresuar nevojat e individëve dhe familjeve* | | | përfshirë në procesin e identifikimit të individëve në nevojë për shërbime në territorin ku punojnë. | | | | |
| **Aktiviteti 1.3. Punonjësit e Nj.V.N. R menaxhojnë rastet sociale në nevojë për mbrojtje duke kryer:**<br>*Vlerësimin Fillestar dhe trajtim të rasteve emergjente;*<br>*Vlerësimin e Plotë;*<br>*Planifikimin e Mbrojtjes dhe Përkujdesit;*<br>*Përgatitjen e dokumentacionit për marrjen e shërbimit komunitar/familje/rezidencial sipas kritereve ligjore*<br>*Zbatimi, Monitorimi dhe Ndjekjen e Planit;*<br>*Mbylljen e Rastit.*<br>*Punonjësit e NJVNR sigurojnë pjesëmarrjen e individit dhe familjes përgjatë çdo hapi të procesit të menaxhimit të rastit që nga identifikimi dhe deri tek mbyllja e rastit.* | Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (të gjitha) | Vazhdimisht sipas rasteve të referuara | Numri i rasteve të referuara;<br>Numri i rasteve të menaxhuara;<br>Numri i individëve të referuar tek shërbimet sipas nevojës;<br>Numri i individëve që janë informuar e këshilluar nga stafi i NJVNR.<br>Numri i individëve të asistuar nga stafi për përgatitjen e | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"<br>Ligji "Për vetqeverisjen vendore"<br>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare"<br>Ligji "Për ndihmën ekonomike" | Bashkia Malësi e Madhe<br>Grupet teknike ndërsektoriale | - | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale<br>Administratori i Njësisë Administrative |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | dokumentacionit me qëllim përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror;<br>Numri i individëve të fuqizuar në saj të përpjekjeve të koordinuara të drejtuara nga NjVNR. | | | | |
| ***Objektiv specifik 2:*** ***Forcimi i koordinimit dhe qasjes ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve*** | | | | | | | |
| **Aktiviteti 2.1. Ngritja dhe funksionimi i Grupit Ndërsektorial ad hoc, në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve.**<br><br>*Kryetari i Bashkisë drejton takime të paktën një herë në 4 muaj të grupit.*<br><br>*Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës* | Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës | shtator 2025, 2026, 2027, 2027<br>Shkurt 2026, 2027, 2027<br>Qershor 2026, 2027, 2027 | Numri i takimeve të zhvilluara;<br>Numri i drejtuesve të institucioneve pjesëmarrës në takim;<br>Minutat e takimeve të zhvilluara;<br>Numri i raporteve të | Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" | Bashkia Malësi e Madhe | 91 000 | Nënkryetari i Bashkisë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Raporton mbi funksionimin e sistemit të mbrojtjes dhe referimit, koordinimin ndërinstitucional, si dhe situatën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në territorin e Bashkisë* | | | prezantuara në secilin takim;<br>Nisma të përbashkëta të ndërmarra dhe praktika pune ndërinstitucionale të përmirësuara; | | | | |
| **Aktiviteti 2.2. Menaxhimi i rasteve të mbrojtjes së fëmijëve përmes Grupit Teknik Ndërsektorial**<br><br>*Grupi Tenik Ndërsektorial mblidhet me kërkesën e NJMF për vlerësimin e plotë, hartimin dhe miratimin e planit individual për mbrojtjen e fëmijës, përcaktimin e ndërhyrjeve dhe veprimeve të nevojshme nga organe apo struktura të ndryshme, marrjen dhe heqjen e Masës Emergjente dhe Masës së Mbrojtjes, zbatimin, monitorimin dhe rishikimin periodik të PIM.* | Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës<br>Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës | Sipas nevojave për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje | Numri i rasteve të menaxhuara përmes qasjes ndërsektoriale;<br>Numri i takimeve të zhvilluara;<br>Numri i përfaqësuesve të institucioneve pjesëmarrës në takim; | Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" | Bashkia Malësi e Madhe<br>Strukturat, arsimore, shëndetësore, policia, prokuroria, gjykatat, ofruesit e shërbimeve | - | Nënkryetari i Bashkisë<br>Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale |
| **Aktiviteti 2.3. Takime informuese me institucionet** | Njësia e Mbrojtjes së | 2025 | Numri i takimeve të | Ligji "Për të drejtat dhe | Bashkia Malësi e | 80 000 | Sektori i ndihmës |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve**<br>*Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës në bashkëpunim me përfaqësuesin e institucionit lokal respektiv realizojnë sesion informues me stafet e:*<br>*Policisë vendore; Shëndetësisë; Arsimit; Drejtësisë; Prokurorisë*<br><br>*Takimet synojnë informimin e institucioneve mbi procedurat e punës për menaxhimin e rasteve sociale; sistemin e referimit dhe njohjen me shërbimet e ngritura në territor;* | Fëmijës | | zhvilluara; Numri i individëve të informuar në sajë të takimeve të zhvilluara; Ndërveprim i përmirësuar mes NJMF dhe institucioneve të tjera që kanë role dhe përgjegjësi sipas ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. | mbrojtjen e fëmijëve" | Madhe | | ekonomike dhe shërbimeve sociale |
| ***Objektiv specifik 3.** Forcimi i koordinimit dhe qasjes ndërsektoriale për barazinë gjinore dhe masa kundër dhunës në familje* | | | | | | | |
| **Aktiviteti 3.1: Ngritja dhe funksionimi i Komitetit Drejtues Lokal në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës.** | Koordinatori vendor i barazisë gjinore | Shtator 2025, 2027, 2027, 2027 Shkurt 2027, 2027, 2027 | Numri i takimeve të zhvilluara; Numri i drejtuesve të institucioneve pjesëmarrës në takim; Minutat e | Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" | Bashkia Malësi e Madhe | 91 000 | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Kryetari i Bashkisë drejton takimet e Komitetit të paktën një herë në 4 muaj*<br><br>*Koordinatori i barazisë gjinore në Bashki raporton mbi funksionimin e sistemit të mbrojtjes dhe referimit, koordinimin ndërinstitucional, si dhe mbi situatën e dhunës në familje në territorin e Bashkisë* | | Qershor 2027, 2027, 2027 | takimeve të zhvilluara;<br>Numri i raporteve të prezantuara në secilin takim;<br>Nisma të përbashkëta të ndërmarra dhe praktika pune ndërinstitucionale të përmirësuara; | | | | |
| **Aktiviteti 3.2: Menaxhimi i rasteve të dhunës në familje përmes funksionimit të Ekipit Teknik Ndërdisiplinor**<br><br>*Koordinatori vendor organizon punën për thirrjen e mbledhjes së Ekipit Teknik Ndërdisiplinor;*<br><br>*Grupi Teknik Ndërsektorial mblidhet për vlerësimin e plotë, hartimin dhe miratimin e planit individual për mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje, përcaktimin e ndërhyrjeve dhe* | Koordinatori vendor i barazisë gjinore<br>Punonjësit socialë të Nj.V.N.R | Sipas nevojave për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje | Numri i rasteve të viktimave të dhunës në familje të menaxhuara përmes qasjes ndërsektoriale;<br>Numri i rasteve që viktima është mbështetur me shërbime dhe/ose fuqizuar; | Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" | Bashkia Malësi e Madhe<br>Institucionet pjesë e ekipit Teknik ndërdisiplinor | - | Nënkryetari i Bashkisë<br>Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *veprimeve të nevojshme nga organe apo struktura të ndryshme, mbështetjen me shërbime etj.* | | | Numri i takimeve të zhvilluara; Numri i përfaqësuesve të institucioneve pjesëmarrës në takim; | | | | |
| **Aktiviteti 3.3. Takime informuese me institucionet vendore përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave**<br>*Koordinatori vendor në bashkëpunim me përfaqësuesin e institucionit lokal respektiv realizojnë sesion informues me stafet e:*<br>*Policisë vendore; Shëndetësisë; Arsimit; Drejtësisë; Prokurorisë*<br><br>*Takimet synojnë informimin e institucioneve mbi procedurat e punës për menaxhimin e rasteve sociale; sistemin e referimit dhe njohjen me shërbimet e ngritura në territor;* | Koordinatori vendor i barazisë gjinore | 2025 | Numri i takimeve të zhvilluara; Numri i individëve të informuar në sajë të takimeve të zhvilluara; Ndërveprim i përmirësuar mes Bashkisë dhe institucioneve të tjera që kanë role dhe përgjegjësi sipas ligjit për masa kundër dhunës në marrëdhëniet | Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" | Bashkia Malësi e Madhe | 80 000 | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | familjare. | | | | |

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3 - NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I RRJETIT LOKAL TË SHËRBIMEVE KOMUNITARE TË KUJDESIT SHOQËROR

| AKTIVITETET | AKTORËT PËRGJEGJËS | AFATI | TREGUESIT | BURIMI I TË DHËNAVE | BURIMI I FINANCIMIT | KOSTO | MONITORIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktiviteti 1: Ngritja dhe funksionimi i Qendrës multifunksionale për fëmijën dhe familjen në njësinë administrative Koplik**<br>***Përfshin shërbimet:***<br>o *Program për fëmijët e familjeve në ndihmë ekonomike. Shërbimet përfshijnë ushqim, mbështetje për edukim, mbështetje psikologjike dhe sociale, aktivitete të kohës së lirë që nxisin edukimin dhe integrimin*<br>o *Trajtim përmes pakove ushqimore dhe kiteve higjenike për rastet emergjente të familjeve apo individëve në* | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale | 2027 - 2027 | Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për ofrimin e shërbimeve komunitare;<br>Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik;<br>Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimeve | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji "Për vetqeverisjen vendore" VKM nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat | Bashkia Malësi e Madhe<br>MSHMS<br>Donatorë | 24 018 400 | Nenkryetari i Bashkise |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *nevojë.*<br>o *Shërbim reabilitues për fëmijët në konflikt me ligjin.*<br>o *Programe këshillimi për prindërimin.*<br>o *Programe për menaxhimin e zemërimit për prindërit e dhunshëm.*<br>o *Këshillim psikologjik individual për çdo fëmijë në nevojë për mbrojtje*<br>o *Programi i trajnimit të familjes kujdestare (shërbim i kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror të përkohshëm).*<br><br>Për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit ky aktivitet përfshin:<br>*Akt. 1.1 Përgatitja e infrastrukturës së qendrës sipas profileve të shërbimeve*<br>*Akt. 1.2 Struktura e personelit dhe pëgatitja e protokolleve operative të punës*<br>*Akt. 1.3 Trainim i stafit për* | | | sipas tipit të shërbimit;<br>Numri i përfituesve të shërbimeve që ofron qendra; Shërbimi ofrohet në cilësinë që përcaktojnë standartet kombëtare për secilin shërbim që përmban qendra; | për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *ofrimin e shërbimeve*<br><br>***Akt. 1.4*** *Funksionimi i shërbimit.* | | | | | | | |
| **Aktiviteti 2. Numër i dedikuar për rastet e emergjencës për individët në nevojë**<br><br>*Në nivelin e Bashkisë vendoset dhe publikohet numër telefoni profesional i dedikuar për informim, koordinim, referim të rasteve të fëmijëve, viktimave të dhunës në familje dhe çdo rast emergjence në nevojë për mbrojtje dhe shërbim.* | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale | 2025 | Numri i dedikuar i publikuar në ambientet e Bashkisë, njësive administrative, institucioneve publike lokale, faqen e ëeb të Bashkisë;<br><br>Numri i telefonatave të marra nga individë në nevojë për mbrojtje dhe/ose shërbime; | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji "Për vetqeverisjen vendore" VKM nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet | Bashkia Malësi e Madhe | 111 690 | Nenkryetari i Bashkise |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" | | | |
| **Aktiviteti 3: Ngritja dhe funksionimi i shërbimit të emergjencës 72 orë për viktimat e dhunës në familje.**<br>*Për nritjen dhe funksionimin e shërbimit ky aktivitet përfshin:*<br>***Akt. 3.1*** *Ngritja e infrastrukturës fizike të këtij shërbimi, përshkrimet e punës dhe trainimi i stafit*<br>***Akt. 3.2*** *Shërbim ligjor dhe psikologjik përgjatë kohës së marrjes së shërbimit 72 orësh dhe shërbim riintegrues në vijim. Paketa ushqimore dhe higjenike.* | Koordinatori vendor për masat kundër dhunës në familje | 2025-2027 | Streha e emergjencës funksionale për çdo rast;<br>Staf i dedikuar dhe i trainuar për shërbim;<br>Numri i rasteve të akomoduara në kushtet e emergjencës;<br>Numri i rasteve që kanë përfituar shërbimin ligjor dhe psikologjik; | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji "Për vetqeverisjen vendore" VKM nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e | Bashkia Malësi e Madhe<br>MSHMS<br>Donatorë | 2 936 525 | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" | | | |
| **Aktiviteti 4: Ngritja dhe funksionimi i shërbimit të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror në familje kujdestare**<br>Për ngritjen e shërbimi ky aktivitet përfshin:<br>***Akt. 4.1*** *Trainim i strukturave lokale përgjegjëse mbi shërbimin e kujdesit për fëmijë në familje kujdestare*<br>***Akt. 4.2*** *Informimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit lokal për të qenë familje kujdestare*<br>***Akt. 4.3*** *Identifikimi, orientimi dhe trainimi i familjeve kujdestare*<br>***Akt. 4.4*** *Ndjekja e procedurave ligjore për regjistrimin e familjes kujdestare dhe ngritjen e regjistrit të familjeve* | Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës<br>Punonjësit Social të NJVNR<br>Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në NjVNR<br>Grupi multidisiplinar | 2027 | Numri i familjeve të informuara mbi shërbimin;<br>Numri i familjeve të vlerësuara, trainuara si familje të mundshme kujdestare;<br>Numri i familjeve të shqyrtuara nga komisioni multidisiplinar<br>Nurmi i familjeve të regjistruara | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" VKM nr. 149, datë 13.3.2018 "Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës | Bashkia Malësi e Madhe | 864 500 | Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *kujdestare në Bashki*<br>***Akt. 4.5*** *Procedurat e vendosjes së fëmijës në Familje kujdestare*<br>*(vlerësimi i fëmijës; vlerësimi i familjes biologjike; vlerësimi i familjes kujdestare; masa e mbrojtjes, vendosja dhe monitorimi në familjen kujdestare.)* | | | në regjistrin e familjes kujdestare;<br>Numri i fëmijëve të vendosur në mënyrë të menjëhershme në familje kujdestare;<br>Numri i fëmijëve të vendosur në familje kujdestare me vendim gjykate;<br>Numri i monitorimeve të kryera në familjet kujdestare;<br>Cilësia e jetës së fëmijëve të vendosur në familje kujdestare; | së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare" | | | |
| **Aktiviteti 5: Qendër ditore për fëmijët me aftësi të** | Sektori i ndihmës ekonomike dhe | 2025-2027 | Infrastruktura e godinës e | Ligji "Për shërbimet e | Bashkia Malësi e | 15 786 480 | Nenkryetari i Bashkise |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
